



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.09.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 13:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare ligjore pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës së sotshme lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Kurushi fillimisht relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë:

a. Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë:

a. Gjkata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

II. Gjkata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

III. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ:

1. Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

¹ Proceverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

B. Gjykatat e Apelit sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm:

1. Gjykata e Apelit Korçë;
2. Gjykata e Apelit Durrës;
3. Gjykata e Apelit Vlorë.
4. Gjykata e Apelit Gjirokastrë (me dy raunde).

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: Z. Besnik Shehu.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari z. {...} për shkak se ka paraqitur një kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja {...} për shkak të ngarkesës.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, 2 dhe 3, gjyqtarja Gentiana Shukullari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke përfshirë edhe gjyqtarin e transferuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, konkretisht: Znj. Suela Dashi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 penale, gjyqtarja Blerta Çibuku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3 (tre).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit (në footnote përmenden emrat e gjyqtarëve që duhet të përjashtohen nga shorti për shkak të papajtueshmërisë ligjore). Zoti Kurushi bën sqarimin se kjo çështje bën pjesë në morinë e çështjeve të gjykuara nga gjykata e posaçme e shkallës së parë për korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështje të cilat kanë elementë të përbashkët me njëra-tjetrën, për shkak të natyrës së tyre si procedime penale të lidhura referuar nenit 79 të K.Pr.Penale. Kështu që hetimi i çështjeve të ndara si në fazën e hetimit nga prokuroria por edhe në fazën e gjykimit nga gjykata ku janë caktuar gjyqtarë, bën të mundur që një pjesë e gjyqtarëve që kanë gjykuar çështjet e mëparshme penale të cilat kanë natyrën e procedimit të lidhur me çështjen e sotme që kërkohet të caktohen tre gjyqtarë të tjerë, bën të pamundur listën e gjatë që është përgatitur për t’iu

nënshtuar shortit të radhës. Në këtë rast vihet në dijeni që është një numër i madh gjyqtarësh të caktuar më përpara dhe kanë papajtueshmëri për të gjykuar këtë çështje për shkak se kanë gjykuar çështje të tjera të ngjashme. Këto gjyqtarë janë: Gjyqtarët që kanë pengesë Etleva Deda, Irena Gjoka, Flora Hajredinaj, Erion Çela, Erion Bani, Flojera Davidhi, Atalanta Zeqiraj. Gjithashtu kanë pengesë sepse kanë gjykuar të pandehurit në procedim të lidhur gjyqtarët: Diamela Goxha, Migena Laska, Manjola Xhaxho, Adelajda Gjuzi, Ilir Përdeda, Petrit Çomo, Rexhep Bekteshi, Arbana Selmanaj, Matilda Llangozi.

Deri në këto momente nuk kanë papajtueshmëri lidhur me çështjen gjyqtarët: Taulant Banushi, Alma Kolgjoka, Aurel Arapi, Artan Çupi, Esmeralda Xhili, Gerd Hoxha dhe Elsa Ulliri, të cilët janë gjyqtarë që plotësojnë kriteret e përmendura më lart (vjetërsia në punë, seksioni penal si dhe kanë kaluar me sukses procesin e vetingut).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Artan Çupi (relator), Elsa Ulliri dhe Taulant Banushi (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore administrative, (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja Klodiana Veizi Mema, referuar kjo vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi përjashtimin e saj nga shortet e radhës.

Në shortimin e çështjeve në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti zv/kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës z. Adrian Shega sepse pjesëmarrja e tij e bën më të pranueshëm numrin e gjyqtarëve që do t'i nënshtrohen shortit të radhës.

Bën një sqarim zoti Kurushi: Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kanë dhënë dorëheqjen për shqyrtimin e dy kërkesave pasi paditëse në të dyja kërkesat rezultoi të jenë sekretaret gjyqësore që ushtrojnë funksionet e tyre administrative pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Njëkohësisht, zv/kryetarja e gjykatës në detyrë ka paraqitur kërkesën për dorëheqje.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2 gjyqtari Ledio Sali.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore (me karakter tepër urgjent), në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat

dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, të cilët janë të planifikuar për të gjykuar çështje gjyqësore në gjykatën e apelit Korçë datë 16 shtator. Për shkak të urgjencës propozohet që gjyqtarët e përzgjedhur në dy shortet e fundit nga KLGJ-ja të jenë gjyqtarët të cilët do të përzgjidhen edhe sot në shortin e radhës për të vijuar gjykimin e çështjes me natyrë tepër urgjente (shorti të hidhet mes gjyqtareve Ornela Naqellari, Marsela Dervishi, Emona Muçi, Alma Ahmeti, Elona Mihali).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: znj. Valdete Hoxha; Si edhe gjyqtari z. {...}, pasi është zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Alma Ahmeti Zhupa.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Astrit Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në ndryshim nga rregulli i zakonshëm në shortimin e çështjes të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: znj. Irena Brahim, për shkak të numrit të gjyqtarëve që do të shortohen dhe për shkak të faktit se një nga këto çështje gjyqtarja Miranda Andoni aktualisht është pjesë e përbërjes së trupit gjykues, kështu që përjashtimi i gjyqtarës Irena Brahim do të reduktonte në maksimum numrin e gjyqtarëve që do t'i nënshtroheshin shortit të radhës.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Arben Dosti.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Miranda Andoni.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, 3 në lëndë penale dhe 3 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Sqarim nga zoti Kurushi mbi dy raundet e hedhjes së shortit: Për çështjen e parë propozohet që shorti të zhvillohet ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë sepse gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë janë të konsumuar në çështje të tjera të shqyrtuara nga ana e tyre për shkak të procedimeve të lidhura që ka kërkesa për pushimin e procedimit penal me çështjet që janë në shqyrtim ose janë të shqyrtuara më përpara nga gjyqtarët e apelit Vlorë si dhe nga gjyqtarët e apelit Gjirokastrë. Edhe Gjykata e Apelit Korçë ndodhet në pamundësi për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve si dhe për shkak të faktit që edhe një prej gjyqtarëve të kësaj gjykate që është z. Hasani ka pengesë ligjore për t'u përfshirë në shortin e radhës.

Ndërsa në lidhje me çështjet e tjera, propozohet që shorti të hidhet ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë, për shkak të afërsisë gjeografike që ekziston ndërmjet dy gjykatave.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat

dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë (për çështjen nr.1) dhe Gjykata e Apelit Vlorë (për çështjet nr. 2 - nr. 6), duke përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje të jetë 1, dhe numri i gjyqtarëve për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë 2.

Për 1 çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar të përzgjidhet me short 1 i tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, duke përjashtuar gjyqtarët e caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë;

Për 5 (pesë) çështje për të cilat kërkohen në 1 rast 2 gjyqtarë dhe në 4 raste nga 1 gjyqtar, të përzgjidhen me short 2 të tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, duke përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve me numër rendor 2 - 6, të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: znj. Iliba Bezati.

Në shortimin e çështjes nr. 1 të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: znj. Valdete Hoxha.

Të përjashtohen nga shorti gjyqtarët të cilët janë caktuar nga KLGJ për gjykimin në Gjykatën e Apelit Korçë: Edlira Petri, Elona Toro, Emona Muçi, Alma Ahmeti, Lutfije Celami, Marsela Dervishi, Elona Mihali, Ornela Naqellari.

Të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja Irida Kacerja e caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Fatri Islamaj.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Laurent Fuçia.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtarët Genti Dokollari dhe Laurent Fuçia.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtari Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 6, civile, gjyqtari Laurent Fuçia.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor